V E N D I M
Nr. 671, datë 15.12.2000

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT MJEKËSOR TË PËRCAKTIMIT TË VERBËRISË
(Ndryshuar me VKM nr. 221, datë 10.4.2003)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbërit", me propozimin e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV), për përcaktimin e personave që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Komsioni e ka qendrën në Tiranë dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Numri, përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përcaktohet nga ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. KMPV-ja kryen detyrat dhe ka të drejtat e përcaktuara për KMCAP-në, sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimin nga statusi i të verbërit"

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përfundojnë procedurat e kalimit të përgjegjësive nga KMCAP në KMPV. Ngarkohet drejtori i Shërbimit Social Shtetëror të normojë dhe të kontrollojë procesin e kalimit të këtyre përgjegjesive.

4. Kriteret mjekësore, për përfitimin nga "statusi i të verbërit", janë të veçanta dhe përcaktohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe nga Ministria e Shëndetësisë.

5. *Pagesa e mjekëve dhe e anëtarëve të tjerë të komisionit të bëhet në bazë të pjesëmarrjes në çdo komision dhe, përkatësisht, për kryetarin e komisionit në masën 23 për qind, ndërsa për anëtarët e komisionit 20 për qind të pagës mujore, sipas strukturës së pagave të përcaktuara në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë", kreu I.1, lidhja nr.1, emërtimi "mjek", por jo më shumë se një pagë mujore e këtij emërtimi. Komisioni mblidhet jo më shumë se katër herë në muaj.*

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga pagesat për KMPV-në, të përballohen nga fondi i Shërbimit Social Shtetëror.

7. Në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", bëhen ndryshimet si vijon:

a) "Kudo në vendim ku përmendet "KMCAP" (të rrethit përkatës) të zëvendësohet me "KMPV".

b) Paragrafi i parë, pika 3 të riformulohet:

"Shoqata e të verbërve të Shqipërisë lëshon librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, e cila nuk është e njëjtë me librezën e anëtarësisë. Librezat e verbërisë jepen vetëm kur Kryesisë së Shoqatës të së Verbërve të Shqipërisë i vihen në dispozicion nga KMPV-ja, raportet mjekësore dhe dokumentacioni tjetër, i nevojshëm për çdo person.".

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta